



Funded by
the European Union



THIRRJE PËR PJESËMARRJE “RRJETI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE”

Jeni përfaqësues i shoqërisë civile i interesuar në mbrojtjen e konsumatorëve shqiptar?
Jeni përfaqësues i sektorit të biznesit i interesuar në mbrojtjen e konsumatorëve shqiptar?
Doni të avokoni për produkte cilësore, të sigurta, për standarde më të larta?

Bëhuni pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Rrjetëzimi i aktorëve nga të gjithë sektorët, shoqëria civile, biznesi dhe sektori publik, është ndër instrumentet bazë për nxitjen e koordinimit dhe bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Qendra “Konsumatori Shqiptar” (QKSH/ACC) ka ngritur Rrjetin për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Zgjerimi i rrjetit dhe fuqizimi i tij janë rrugët kryesore për përparimin në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Anëtarët e Rrjetit do të takohen periodikisht për të diskutuar, rekomanduar dhe avdokuar lidhur me çështje të ndryshme të mbrojtjes së konsumatorëve, sfidat e Shqipërisë në procesin e Integritetit, pjesëmarrjes në Platformën e Partneritit të Integritetit Evropian.

Fuqizimi i Rrjetit bëhet në kuadër të projektit “Shoqëria civile në veprim për përpjekje të kordinuara për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit” (SAFECons), që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” (QKSH/ACC) në partneritet me Qendrën Kombëtare Burimore të Trajnimit dhe Asistencës Teknike (QKBTAT/ANTTARC). Objektiva e projektit është “fuqizimi i rolit të shoqërisë civile për zbatimin e legjislacionit mbi sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri”.

Zgjerimi dhe fuqizimi i Rrjetit për Mbrojtjen e Konsumatorëve është i domosdoshëm për rritjen e efektivitetit të përpjekjeve për mbrojtjen e konsumatorëve jo vetëm në kuadrin e projektit, por edhe në vazhdimësi.

Nëse dëshiron të bëhesh pjesë e Rrjetit: Shprehjen e interesit së bashku me një CV dërgojeni brenda datës 27 Tetor 2025, në adresën e email:

qendrakonsumatorishqiptar@gmail.com info@anttarc.org